
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., GJAKOVË, 50000, UJEZ Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	09.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **08.07.2024**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.** me adresë në **Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.** me adresë në **Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **03.07.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K. me adresë në **Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **03.07.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **08.07.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit *B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf professional:

2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore, me përvojë pune ne projektim min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

• Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Udhëheqësi i Punishtes, keni prezantuar z. Shemsi Daka;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar: Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore, me përvojë pune ne projektim min. 5 vite pas diplomimit;

Inxhinieri në fjalë është Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.4. Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Një (1) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, keni prezantuar z. Driton Caka;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar:

- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;

Ku dokumentet ne fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 1 citoj:

1. Si pikë e parë e eliminimit ka qenë Ing. I Ndërtimtarisë, ku kërkesë e AK Komuna e Rahovec ka qenë:

2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Andaj nuk jemi të vetmit në këtë aktivitet të prokurimit që kërkesën e AK Komuna e Rahovecit e kemi kuptuar ose menduar “**NDRYSHE**” sepse tek kërkesa e AK ceket Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë **OSE** Master-Drejtimi Infrastruktura Rrugore, andaj nuk është dashur që nga AK Komuna e Rahovecit të konsiderohet si një nga arsyet për eliminim nga aktiviteti i prokurimit.

Po ashtu Komuna e Rahovecit po bie në kundërshtim me vetveten sepse kërkesa është Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë, pra edhe Ing. Z.Shemsi Daka i paraqitur nga ana e jonë është e njëjta gjë pra ka Fituar Titullin: **Ingjinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë** por që Programi ndryshon e jo Drejtimi. Por pas komunikimeve tona me Fakultetin e Ndërtimtarisë (UNI PR) jemi informuar se Programi Infrastruktura Rrugore nuk është më pjesë e programeve Bachelor ose Master e Fakultetit të Ndërtimtarisë, andaj kjo ka qenë dashë të merret parasysh edhe nga ana juaj.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit në këtë rast po e dëmton dhe rrezikon buxhetin në Vlerë prej **100,931.00 euro**, e njëherazi duke rënë ndesh edhe me Nenin 6 i LPP-së - që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Sipas **nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës**, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne bazë të formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, me datë: **03.07.2024**, ju kemi cekur arsyet se tenderi juaj Refuzuar për arsyeje te cekura më lartë ;

Në Njoftimin për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), **keni pasur afatin kohor për Sqarimin e Dosjes së Tenderit;**

Pranimi i një Drejtimi tjetër, që nuk është në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), është në Kundërshtim me Nenin 4.1 të FDT-së:

Variantet	4.1	Variante autorizohen: Jo <input checked="" type="checkbox"/>
-----------	-----	--

Në Njoftimin për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), kemi kërkuar që **Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master, të jetë i Drejtimi Konstruktiv**, ku në ofertën e juaj të dorëzuar, **për këtë pozitën, keni prezantuar z. Enver Gashi**;

Në Njoftimin për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), kemi kërkuar që **Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master, të jetë Drejtimi Infrastruktura Rrugore, me përvojë pune ne projektim min. 5 vite pas diplomimit**, ku në ofertën e juaj të dorëzuar, **për këtë pozitën, keni prezantuar z. Shemsi Daka – INXHINER I DIPLUAR I NDËRTIMTARISË – DREJTIMI KONSTRUKTIV**, ne bazë të Diplomës Nr. 561, datë: 12 Prill 2007;

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i PABAZUARA

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 citoj:

Pra sipas asaj më lartë Ing. për Menaxhimin e Emergjencave e plotësoni kërkesen e AK-së, por që për shkak të kapacitetit voluminoz të Dosjes së Tenderit kanë mbetur pa ngarkuar CV-ja dhe Referenca për punët e mëparshme të Injinerit e të cilat bëjnë pjese n CV-në e Injinerit z.Driton Çaka. AK Komuna Rahovec e citon **Nenin 72**, Paragrafi 3 ku thotë se *“Sigurimi i Informacionit qe munogon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar...”* andaj sipas neve AK bie në kundërshtim me **Nenin 72**, ku siq shihet edhe me lartë dokumentet ne bazë të të cilave AK ka mundë të kërkoj informacione sqaruese ose dokumentet *“ekzistenca e të cilave është e fiksuar”* i ka pasur të ngarkura ne dosje si Diplomat e Ing. dhe ID e injninerit, pra AK ka rënë ndesh edhe me Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik:

CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkojen informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkojen informata sqaruese	69

“CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar – Mund të kërkojen dokumente sqaruese – Neni 69 i LPP-së.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Sipas **nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës**, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne bazë të formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, me datë: **03.07.2024**, ju kemi cekur arsyet se tenderi juaj Refuzuar për arsyeje te cekura më lartë ;

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, keni prezantuar z. Driton Çaka;

Nënshkrimi në CV-në nga Inxhinieri, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe pranimi i Sqarimeve për **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit**, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve;
Sqarimi i këtyre dokumentacioneve është në kundërshtim me **Nenin 72 pika 3 i LPP – së i cili e përcakton si në vijim: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive;**
Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i PABAZUARA

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 3 citoj:

Me qasjen tonë kemi vrejtur se GOE i rekomanduar për dhënje të kontrates nga AK është OE i pa përgjegjshëm:

- GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmoj se e plotëson “*Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Pika 9.1 & 9.2*”
Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO

Përveq Liderit të Grupit që i ka paraqitur ISO Standartet anëtari i tjetër nuk ka arritur të dëshmoj që është i Certifikuar me të njëjtat, ku në këtë rast Autoriteti bie në kundërshtim me Neni 26.6 Grup i Operatorëve Ekonomik – KRPP, ku citohet:

Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standartet përkatëset.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Për këtë çështje ju lutem Referoheni **RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES dhe Vendimit të OSHP-së me Nr. 2023/0990**

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i PABAZUARA

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>